



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2018:006193

Datë: 17.01.2019

Numri i dokumentit: 00207175

P.nr.326/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRIZREN DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM DIVIZIONI PENAL Sipas gjyqtarit Refki Piraj, me pjesëmarrjen e procesmbajtësit Halime Nixha në lëndën penale kundër të pandehurit L.P nga Prizren, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi kontroll ose posedim të pa autorizuar të armeve nga neni 374 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës Nr.04/L-082 (KPRK), duke vendosur sipas aktakuzës së Prokuroris Themelore Prizren - Departamenti i përgjithshëm nr. PP/II.nr.220-3/18 , të datës 28.02.2018 në praninë e Prokurorit të Shtetit Musli Gashi të akuzuarit L.P, me datë 17.01.2019 mori, këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri

L.P i lindur më ..., me numër , i biri i T.P dhe nënës R. P, e gjinisë , K. me vendbanim në , Prizren, ... pn. ka të kryer shkolle e mesme, i pamartuar, punëtor, i gjendjes së dobët ekonomike shqiptar shtetas i R.te Kosoves.

ESHTE FAJTOR

Se me datën 18.01.2018 rreth orës 9,25 min, në Prizren, mbanë në pronësi kontroll ose posedim të pa autorizuar të armeve në atë mënyrë që shpërndanë në rrjetin social një foto me armë zjarri, hetuesit policorë kanë kontaktuar me të pandehurin ku në shtëpinë e tij është gjetur në posedim të një arme të zjarrit – pistolette e tipit “Zastava 6.35” e kalibrit 9mm, me numër serik ... se bashku me një karikatorë të zbrazet pa pasur leje nga organi kompetent të cilat janë sekuestruar nga ana e zyrtarit policor.

Këso dore ka kryer veprën penale penale mbajtja në pronësi kontroll ose posedim të pa autorizuar të armeve nga neni 374/1 i Kodit Penal

Andaj gjykata ne kuptim te nenit 3,4.41.43./46, të KP-se, , te pandehurit i shqipton :

DENIM ME GJOBË

Duke i shqiptuar dënimin me të holla ne shume prej 500 (pesëqind) euro, të cilin dënim do ta paguaj ne xhirollogarinë e kesaj gjykate, nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi , e po qese dënimi me te holla nuk mund te paguhet nga ana e te akuzuarit ne afatin e sipërpërmendur, i njëjti do te zëvendësohet me denim burgu duke llogarite 20 euro , nje dite burg (25 dite burg) .

DENIMI PLOTESUES

Te akuzuarit i shqiptohet dënimi plotësues marrja – konfiskimi i pistoletës te markës “Zastava 6.35” kal.8mm P.A. me nr.... dhe nje karikator i pistoletës si objekt i kryerjes se veprës penale.

Obligohet I pandehuri qe ti paguaj te gjitha shpenzimet e procedures penale sa ato behen ne baze te llogarisë se gjykatës, ne emër te paushallit gjyqësor te paguaj shumen prej 20 euro, ne afat prej 15 ditesh nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi nen kërcënim te ekzekutimit te dhunshëm.

Ne zbatim te ligjit per Kompensimin e viktimave te krimit obligohet i akuzuari qe te paguan taksën ne shume prej 30 (tridhete) euro ne afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, ka paraqitur aktakuzën PP/II.nr.220-3/18 , të datës 28.02.2018 , ndaj te akuzuarit L.P nga Prizreni për shkak të veprës penale mbajtja ne pronësi, kontroll ose posedim te paautorizuar te armeve nga neni 374 par.1 te kP-së.

I pandehuri L.P , ne shqyrtim fillestar, në tërsi e pranon veprën per te cilën akuzohet, po ashtu ka pranuar edhe fajësinë .

Gjyqtari gjykues përcaktoi se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi te fajit, pranimi është bere vullnetarisht, dhe mbështetet ne faktet e qeshtjes qe përmban aktakuza, aktakuza nuk përmban asnjë shkelje te qarte ligjore ose gabime faktike dhe pas marrjes se mendimit nga ana e prokurorit te shtetit ka pranuar pranimin e fajsisë.

Kjo gjykatë gjeti se në veprimet e të akuzuarit , plotësohen të gjitha elementet qenësore te veprës penale mbajtja ne pronësi kontroll ose posedim te pa autorizuar te armeve nga neni 374/1 i Kodit Penal prandaj dhe ia shqiptoi dënimin me gjobe duke qenë i bindur se me këtë lloj dënimi do te arrihet qëllimi i të njëjtit. Ne përcaktimin e lartësisë se gjobes ,gjykata pati per baze gjendjen e dobet sociale te te akuzuarit.

Me rastin e shqiptimit të dënimit kjo gjykate pati parasyshe si rrethana lehtësuese për të akuzuarin , pranimin e fajësisë, pendimin e shprehur për veprën e kryer, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej me vepra penale, sjelljen korrektë para gjykatës, si dhe moshën relativisht të re.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marrë në kuptim të nenit 450 dhe 452 të KPPK-se.

Vendimi mbi konfiskimin u marrë në kuptim të nenit 62 par.2.7 të KP-së.

Më sa u tha më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi .

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

2018:006193, 17.01.2019

G j y q t a r i

Refki Piraj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.

Numri i lëndës: 2018:006193
Datë: 17.01.2019
Numri i dokumentit: 00207175